

V E N D I M
Nr.1, datë 31.1.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Veli Budo,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Franc Jakova,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Metush Saraçi,	Anëtar i “““
Hilmi Dakli,	Anëtar i “““

me sekretare Drita Filto, në datat 30.10.1995, 10.11.1995, 17.01.1996 dhe 31.01.1996, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.17/2 Akti, që u përket:

K Ë R K U E S: 1. GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALDEMOKRATE, i përfaqësuar nga Skënder Gjinushi, Paskal Milo dhe Gaqo Apostoli.

2. GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE, i përfaqësuar nga Namik Dokle, Fehmi Abdiu dhe Pandeli Majko.

O B J E K T I:

1. Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate : deklarimi antikushtetues i nenit 3 të ligjit nr.8001, datë 22.9.1995 “Për genocidin dhe krimet kundër njerëzimit kryer në Shqipëri gjatë sundimit komunist për motive politike, ideologjike dhe fetare”.

2. Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste : deklarimi antikushtetues i ligjit nr.8001, datë 22.9.1995 “Për genocidin dhe krimet kundër njerëzimit kryer në Shqipëri gjatë sundimit komunist për motive politike, ideologjike dhe fetare” dhe ligjit nr.8043, datë 30.11.1995 “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik”.

GJYKATA KUSHTETUESE pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate dhe Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste kanë parashtruar se është antikushtetues kufizimi i parashikuar në nenin 3 të ligjit nr.8001, datë 22.9.1995 “Për genocidin dhe krimet kundër njerëzimit kryer në Shqipëri gjatë sundimit komunist për motive politike, ideologjike dhe fetare”, për të drejtën për t’u zgjedhur në organet qendrore dhe lokale të pushtetit dhe për t’u emëruar në administratën e lartë të shtetit, në sistemin gjyqësor dhe në masmedia deri më 31 dhjetor 2001 personave që deri më 31 mars 1991 kanë qenë anëtarë të Byrosë Politike dhe të Komitetit Qendror të PPSH-së (dhe PKSH-së), ministra, deputetë të Kuvendit Popullor, anëtarë të Këshillit Presidential, kryetarë të Gjykatës së Lartë, prokurorë të përgjithshëm, sekretarë të parë të rretheve, punonjës të Sigurimit të Shtetit, bashkëpunëtorë të Sigurimit të Shtetit dhe denoncuesit dëshmitarë në dëm të të pandehurve në proceset politike.

Për të mbështetur këtë kërkesë, ata i referohen neneve 2, 4, 8 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” dhe neneve 19, 25 dhe 41 të ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”. Në këto dispozita përcaktohet barazia para ligjit, garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të pranuara në dokumentet ndërkombëtare dhe respektimi nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë i parimeve dhe normave përgjithësisht të pranuara të së drejtës ndërkombëtare, e drejta e zgjedhjes dhe kufizimi i përkohshëm i të drejtave të veçanta.

Duke i patur parasysh normat kushtetuese të mësipërme në kontekstin e përgjithshëm të legjislacionit kushtetues të Republikës së Shqipërisë, aktet dhe normat ndërkombëtare përgjithësisht të pranuara, shkeljen e mohimin e pashembullt të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut gjatë sundimit komunist dhe kushtet e tranzicionit, Gjykata e çmon të pabazuar kërkesën e grupeve parlamentare të Partisë Socialdemokrate dhe Partisë Socialiste, lidhur me kufizimin për një kohë të caktuar të së

drejtës për t'u zgjedhur si dhe të ushtrimit të disa nëpunësive për një kategori personash.

Në pjesën hyrëse ligji kushtetues “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, duke shprehur qëllimin e tij, thekson : “... gjatë diktaturës së egër e tejte çnjerëzore 46-vjeçare të partisë-shtet në Shqipëri janë shkelur e mohuar, nëpërmjet terrorit shtetëror, të drejtat civile e politike, ekonomike, sociale e kulturore si dhe liritë më themelore të njeriut” dhe se “... respektimi dhe gëzimi i gjithanshëm i këtyre të drejtave e lirive përbën një nga aspiratat më të larta të popullit shqiptar dhe një nga parakushtet e domosdoshme për garantimin e lirisë, drejtësisë sociale dhe përparimit demokratik të shoqërisë sonë”.

Janë pikërisht subjektet e parashikuara në nenin 3 të ligjit nr.8001, datë 22.09.1995 dhe nenin 2 të ligjit nr.8043, datë 30.11.1995 autorët, ideatorët dhe zbatuesit e asaj diktature të egër e çnjerëzore të cilën denoncon ligji kushtetues në hyrje të tij. Rrjedhimisht kufizimi përkohësisht i të drejtave të këtyre subjekteve për t'u zgjedhur dhe emëruar në detyra shtetërore të caktuara përbën një garanci për zbatimin e të gjitha dispozitave kushtetuese dhe të akteve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Është e vërtetë sa parashtron Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste se në nenin 25 të “Paktit Ndërkombëtar lidhur me të drejtat civile dhe politike” të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, datë 16 dhjetor 1966, parashikohet që çdo qytetar ka të drejtë të votojë dhe të zgjidhet si dhe të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike. Por, siç përcaktohet në paragrafin e parë të po këtij neni, këtyre të drejtave nuk mund t'i bëhen vetëm “kufizime të paarsyeshme”.

Veç sa sipër, Gjykata ka parasysh se në paragrafin e dytë të nenit 29 të “Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut”, datë 10 dhjetor 1948, përcaktohet se “në ushtrimin e të drejtave të tij, çdo njeri u nënshtrohet vetëm kufizimeve të përcaktuara me ligj dhe vetëm me qëllimin... për t'iu përgjigjur kërkesave të moralit... dhe të mirëqenies së përgjithshme në një shoqëri demokratike”.

Duke u bazuar edhe në këto dispozita ndërkombëtare, Gjykata arrin në konkluzion se ligjet objekt shqyrtimi, përcaktojnë kufizimet e arsyeshme që i përgjigjen edhe kërkesave të drejta morale të shoqërisë sonë demokratike.

Pretendimi i Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate se “asnjë vend i Lindjes nuk ka nxjerrë pas diktaturës ligje të ngjashme që do të kufizonin të drejtën e zgjedhjes për persona të veçantë”, nuk është argument për të vërtetuar antikushtetutshmërinë e dispozitave objekt shqyrtimi. Megjithatë Gjykata vë në dukje se ligje që kanë vendosur kufizime, përfshirë edhe të drejtën e zgjedhjes, janë miratuar në Hungari, Itali, Austri etj.

Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste ka kërkuar shfuqizimin edhe të neneve 1 e 2 të ligjit nr.8001, datë 22.9.1995.

Me nenin 1 ngarkohen organet e prokurorisë për të zhvilluar me përparësi hetimin e veprimtarisë që lidhet me krimet kundër njerëzimit kryer gjatë sundimit komunist.

Kuvendi Popullor me këtë dispozitë nuk del jashtë kuadrit të kompetencave të veta. Sipas pikës 10 të nenit 16 të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, Kuvendi Popullor kontrollon veprimtarinë e Prokurorisë së Përgjithshme.

Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste, duke mbështetur kërkesën e tij për antikushtetutshmërinë e nenit 1, i referohet përmbajtjes së fjalisë së parë të pikës 1 të nenit 15 të Paktit Ndërkombëtar lidhur me të drejtat civile dhe politike të 16 dhjetorit 1966 : “Askush nuk do të dënohet për veprime ose mosveprime të cilat nuk përbëjnë shkelje sipas së drejtës kombëtare ose ndërkombëtare në kohën kur janë kryer”. Por ky referim është i cunguar, sepse në pikën 2 të të njëjtit nen thuhet : “Asgjë në këtë nen nuk duhet interpretuar sikur është kundër gjyqimit ose ndëshkimit të çdo njeriu për veprime ose mosveprime të cilat, në kohën që janë kryer, janë cilësuar si kriminale sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës të njohura nga të gjitha kombet”.

Përsa i përket nenit 2, me të cilin përcaktohet se hetimi e gjykimi i krimeve të parashikuara në nenin 1 do të bëhet sipas Kodit të sotëm të Procedurës Penale, edhe pse e përsërit dispozitën e nenit 525 të Kodit të Procedurës Penale, kjo nuk e bën atë antikushtetues.

Lidhur me ligjin nr.8043, datë 30.11.1995, Gjykata e gjen të bazuar kërkesën e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste për shfuqizimin e shkronjës “j” të nenit 1.

Me nenin 2 të ligjit “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut” dhe nenin 1 të ligjit nr.7755, datë 6.10.1993 “Për shtypin”, garantohet e drejta e shtypit. Profesion i gazetarit është profesion i lirë, i bazuar në nismën e veprimtarinë vetjake dhe nuk ka të bëjë me detyra shtetërore.

Sipas paragrafit të dytë të nenit 6, refuzimi për të dëshmuar ose dëshmia a ekspertimi i remë

para komisionit sjell përgjegjësi penale sipas Kodit Penal. Gjykata konstaton se dëshmia e rreme, refuzimi për të dëshmuar dhe ekspertimi i rremë përbëjnë vepra penale të parashikuara nga nenet 306, 307 dhe 309 vetëm kur ato janë bërë para organit të ndjekjes penale ose gjykatës. Si rrjedhojë këto vepra penale të parashikuara në Kodin Penal, nuk mund të shtrihen edhe për organet e tjera. Prandaj, kjo dispozitë duhet të shfuqizohet, se vjen në kundërshtim me nenin 6 të ligjit “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, pasi nuk është parashikuar si vepër penale më vete. Legjislatori, po ta shohë të nevojshme, mund të miratojë dispozitë të veçantë ku të parashikojë veprën penale me sanksionet përkatëse.

Në nenin 12 është parashikuar edhe e drejta e ministrit të Drejtësisë për të bërë kërkesë për verifikimin e kryesive të partive dhe shoqatave politike. Njohja e kësaj të drejte ministrit të Drejtësisë vjen në kundërshtim me paragrafin e dytë të nenit 6 të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”. Sipas kësaj dispozite partitë politike dhe organizatat e tjera janë krejtësisht të ndara nga shteti. Për këtë shkak, fjalët “nga ministri i Drejtësisë ose “ të nenit 12 duhet të shfuqizohen.

Meqenëse sipas nenit 18, ky ligj shfuqizohet më 31 dhjetor 2001, përjashtimi i bërë për mosshfuqizimin e nenit 14 vjen në kundërshtim me qëllimin dhe afatin e veprimit të ligjit në kohë. Rrjedhimisht, nga neni 18 duhet të hiqen fjalët “14 dhe”.

Në nenin 15 është parashikuar dënimi i prerë (fiks) me 5 vjet burgim për përdorim publik, fshehje, zhdukje, falsifikim të dokumentave e veprime të tjera të kundërligjshme që përbëjnë vepër penale.

Gjykata çmon se kjo mënyrë e caktimit të dënimit fiks bie në kundërshtim me parimin e sanksionuar në paragrafin e dytë të nenit 47 të Pjesës së Përgjithshme të Kodit Penal për individualizimin e dënimit ndaj personit dhe pengon zbatimin e neneve 48, 49 e 50 që bëjnë fjalë për rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Prandaj, në nenin 15 të ligjit, fjalët “5 vjet burgim”, duhet të zëvendësohen me fjalët “burgim gjer në pesë vjet”.

Gjatë shqyrtimit të ligjit në tërësi, Gjykata konstaton se në paragrafin e parë të nenit 8 është parashikuar vetëm afati 15-ditor për marrjen e vendimit nga ana e komisionit, duke mos u siguruar garancitë kushtetuese në rast të mosrespektimit të këtij afati.

Prandaj, Kuvendi Popullor duhet të bëjë plotësimet e nevojshme për garantimin e respektimit të afatit të mësipërm.

Lidhur me pretendimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste se me nenin 3 të ligjit nr.8043, datë 30.11.1995, i njihet pa të drejtë dikastereve të caktuara në këtë dispozitë kompetenca që të mos e zbatojnë në raste të veçanta këtë ligj, Gjykata çmon se nuk ka bazë kushtetuese. Përjashtimet e lejuara për rastet e parashikuara në shkronjat “c”, “ç” dhe “e” të nenit 2 për shkak të veçorive të detyrës, janë kushtëzuar vetëm në rastet kur zbatimi i këtij neni prek interesa të rëndësishme të shtetit dhe kurdoherë pa cenuar qëllimin e vetë ligjit.

Përsa i përket kërimit për përmbajtjen e nenit 4 që rregullon përbërjen e komisionit, Gjykata nuk shprehet në themel, për shkak se nuk u formua shumica e kërkuar sipas nenit 26, paragrafi i parë, të ligjit kushtetues “Për organizimin e drejtësisë dhe Gjykatën Kushtetuese”.

Duke shqyrtuar përmbajtjen e nenit 3 të ligjit nr.8001, datë 22.9.1995 si dhe të nenit 2, të ligjit nr.8043, datë 30.11.1995, Gjykata arrin në përfundimin se përjashtimi i parashikuar në nenin 3 me frazën “me përjashtim të rasteve kur kanë vepruar kundër vijës zyrtare dhe janë larguar vetë në mënyrë publike”, zbatohet për të gjitha shkronjat e nenit 2, përveç shkronjës “f”.

Gjithashtu, Gjykata e çmon të nevojshme të sqarojë se me fjalën “person” të gërmës “a” të nenit 7 të ligjit nr.8043, datë 30.11.1995, duhet kuptuar si personi fizik, ashtu edhe subjekti elektoral.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 24 (pika 2 e 10), 25 dhe 26 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshim e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me shumicë votash,

V E N D O S I :

I. Rrëzimin e kërkesave të grupeve parlamentare të Partisë Socialdemokrate dhe të Partisë Socialiste për shfuqizimin e ligjit nr.8001, datë 22.9.1995 si të pabazuara.

II. Të shfuqizojë dispozitat e ligjit nr.8043, datë 30.11.1995 “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik”, që vijojnë:

1. Shkronjën “j” të nenit 1;
2. Paragrafin e dytë të nenit 6;
3. Fjalët “nga ministri i Drejtësisë ose” të nenit 12;
4. Fjalët “14 dhe” të nenit 18.

III. Në nenin 15 të këtij ligji fjalët “5 vjet burgim” zëvendësohen me fjalët “burgim gjer në pesë vjet”.

IV. Kuvendi Popullor të bëjë plotësimin e nenit 8 të ligjit për sigurimin e garancive kushtetuese në rast të mosrespektimit të afatit 15-ditor të parashikuar në këtë dispozitë.

V. Rrëzimin e kërkesës së Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste për pjesët e tjera të ligjit nr.8043, datë 30.11.1995 si të pabazuar.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi të nesërmen e botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

Urdhërohet pezullimi i zbatimit të shkronjës “j” të nenit 1, të paragrafit të dytë të nenit 6 dhe të fjalëve “nga ministri i Drejtësisë ose” të nenit 12 të ligjit nr.8043, datë 30.11.1995 deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

MENDIMI I PAKICËS

Jam kundër vendimit të shumicës për arsyet që po radhit më poshtë:

1. Neni 3 i ligjit nr.8001, datë 22.9.1992 “Për genocidin dhe krimet kundër njerëzimit kryer në Shqipëri gjatë sundimit komunist për motive politike, ideologjike e fetare”, nuk është ndonjë dispozitë që parashikon përgjegjësi penale.

Ky ligj që i shtrin efektet e tij për të ardhmen, deri në vitin 2001, d.m.th. në kohë të caktuar dhe për grupe e kategori të caktuara personash disponon se “paskëtaj” nuk mund të zgjidhen në organet qendrore dhe lokale të pushtetit dhe as të emërohen në administratën e lartë të shtetit, në sistemin gjyqësor dhe në masmedia duke përcaktuar jo vetëm kohën por edhe personat që kanë patur funksionet e përmendura në atë nen nga data 28.11.1944 e deri në 31 mars 1991. Në fund të kësaj dispozite thuhet se bëhet përjashtim për personat e përmendur, kur ata kanë vepruar kundër vijës zyrtare të asaj kohe dhe janë larguar vetë në mënyrë publike.

Ky ligj me karakter “in future” ka të bëjë me raporte juridike që hyjnë në sferën e marrëdhënieve të së drejtës kushtetuese, kurse përsa i përket çështjes së ndalimit për t’u emëruar në administratën e lartë, kjo e fundit prek marrëdhënie të cilat përfshihen në sferën e së drejtës administrative dhe pastaj ato të drejtësisë duke ndërhyrë edhe deri te masmedia, pra nuk është dispozitë penale.

Në radhë të parë ky ligj u heq apo u kufizon personave të caktuar të drejtën për t’u zgjedhur në të ardhmen në organet qendrore dhe lokale të pushtetit për një kohë të caktuar. Ky kufizim qoftë dhe i përkohshëm vjen në kundërshtim të hapët me përmbajtjen e nenit 19 të ligjit kushtetues nr.7692, datë 31.3.1993 për “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, i cili prerë dhe në mënyrë kategorike përjashton nga kjo e drejtë vetëm shtetasit të cilëve u është hequr zotësia për të vepruar.

Përsa i përket të drejtës për t’u zgjedhur ky ligj bën përjashtim vetëm për të arrestuarit si dhe të dënuarit që janë duke vuajtur dënimin me heqje të lirisë, të cilëve u njihet vetëm e drejta për të votuar. Këtu kemi të bëjmë me një të drejtë të zgjedhjes të cunguar dhe për raste të caktuara në mënyrë të veçantë.

Kështu për të bërë derogime apo ndryshime në ato dispozita qoftë edhe në drejtim të asaj që kërkohet nga neni 3 i ligjit nr.8001, datë 22.9.1995, si dhe ato që kërkohen në ligjin nr.8043, datë 30.11.1995, duhet të nxirret një dispozitë e miratuar sipas rregullave të përcaktuara në paragrafin e dytë të nenit 43 të Dispozitave Kryesore Kushtetuese d.m.th. që këto ndryshime të miratohen nga Kuvendi Popullor me një shumicë prej dy të tretash të të gjithë deputetëve dhe jo me ligj të thjeshtë. Ose kjo si një “çështje madhore” t’i shtrohej një referendumi popullor.

Ndryshe nuk bëhet dot asnjë ndryshim mbasi neni 41 i ligjit për “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut” lejon kufizimin e përkohshëm të ushtrimit të një pjese të të drejtave dhe lirive që njohin këto dispozita kushtetuese me ligj, në kushtet e shpalljes së gjendjes së luftës ose të gjendjes së jashtëzakonshme, që në kohën e sotme nuk ekziston. Periudha e tranzicionit nuk mund të njësohet

kurrësesi me gjendjen e luftës apo me atë të jashtëzakonshme.

Heqja e të drejtës së zgjedhjeve si dënim plotësues nuk figuron as edhe në Kodin Penal të sotshëm. Ky dënim i përkohshëm, për një kohë gjer në pesë vjet, ka qenë hequr edhe nga Kodi i vjetër Penal me ligjin nr. 7769, datë 16.11.1993.

Për mendimin tim kjo shfuqizon nenin 9 të ligjit nr.8043, datë 30.11.1995 “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe të personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik”, përsa i përket dhënies së lejës për të vënë kandidaturën për zgjedhjen në organet qendrore dhe lokale të pushtetit. Duke u nisur nga sa sipër them se për një shtet juridik si ky i yni, nuk kanë vlerë kushtetuese justifikimet se këto “kufizime të arsyeshme” për të drejtën e zgjedhjeve i pranon edhe neni 25 i “Paktit Ndërkombëtar të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së”, datë 23.3.1966, lidhur kjo me të drejtat civile e politike të njeriut si edhe fakti që kufizime të kësaj natyre janë shpallur me ligj edhe në Hungari, Austri, Çekosllovakia etj. Ky konkluzion mendoj se gjen mbështetje edhe te fakti që sa rëndësi i jep të drejtës së zgjedhjes Dokumenti i Mbledhjes së Kopenhagenit, i Konferencës “Mbi dimensionin njerëzor të KSBE-së”, miratuar në 29 qershor 1990.

Te ne e drejta e zgjedhjes është pjesë përbërëse e një ligji kushtetues të miratuar pas zgjedhjeve të 22 marsit të vitit 1992. Pushteti i ri demokratik shpalli këtë kartë të madhe të së drejtave e lirive të njeriut me dimensione humane, të standarteve europiane dhe nga më të përparuarat.

2. Përsa i përket pjesës që bëhet fjalë në nenin 3 të ligjit në fjalë, që personat dhe kategoritë e përmendura atje nuk mund paskëtaj të zënë poste me rëndësi në administratën e lartë shtetërore dhe në sistemin gjyqësor, kjo është një e drejtë ekskluzive e shtetit dhe e administratës së tij. Ajo e ka në dorë të marrë apo të mos marrë në punë kategori e persona që asaj nuk i duken të përshtatshëm prandaj dhe në këtë drejtim nuk kam vërejtje, mbasi shteti ndonjë detyrim ligjor për të marrë në punë këtë ose atë person të caktuar nuk ka.

3. Ligji nr.8443, datë 30.11.1995 “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik” është në vetvete një ligj i ri dhe i “shkëputur” nga i pari dhe aspak vazhdimi i tij. Kjo sepse ai mban një qëndrim krejtësisht tjetër nga ai me nr.8001, datë 22.9.1992. Në ligjin e ri bëhet një zgjerim i madh si nga përmbajtja e qendrave të punës ashtu dhe për personat që punojnë në këto sektorë të cilët do t’i shtrohen kontrollit.

Në ndryshim nga ligji i parë ky i dyti ka të bëjë jo vetëm me të ardhmen, por edhe për kohën e tanishme. Ai u drejtohet personave të përcaktuar në nenin 2 që punojnë në strukturat e parashikuara në nenin 1 të këtij ligji. Kështu sipas nenit 2 po të këtij ligji për të shërbyer në organet dhe funksionet e përmendura në nenin 1 duhet që personi gjatë gjithë periudhës 28.11.1944 gjer më 31.03.1991 të mos ketë qenë asnjëherë e sadopak në strukturat e përmendura në nenin 2.

Por ashtu si deputetëve, të cilëve mund t’u hiqet mandati vetëm për rastet e parashikuara shprehimisht në dispozitat kushtetuese, edhe kryetarëve dhe anëtarëve të këshillave të rretheve, kryetarëve të bashkive, si dhe të komunave dhe anëtarëve të këshillave të bashkive e komunave, mund t’u hiqet mandati vetëm në kushtet e parashikuara në ligjet përkatëse. Prandaj përfshirja e tyre në germën “e” të nenit 1 (veç prefektëve) është e padrejtë.

Gjithashtu me vendim të këtij komisioni nuk mund të largohen nga detyra gjyqtarët dhe prokurorët. Ata kanë një mbrojtje kushtetuese, për natundshmërinë e tyre. Sipas nenit 15 paragrafi i dytë i ligjit “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7591, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”: Është Këshilli i Lartë i Drejtësisë i vetmi autoritet kompetent që mund të vendosë, midis të tjerave, lëvizjen apo largimin e gjyqtarëve të shkallës së parë, të apelit si dhe të prokurorëve.

Po me këtë ligj kushtetues dhe konkretisht në nenin 6, paragrafi i katërt, janë sanksionuar kushtet dhe organi i cili mund të vendosë largimin nga detyra të anëtarit të Gjykatës së Kasacionit, ashtu siç është garantuar dhe janë përcaktuar kushtet edhe në nenin 29 si dhe organi i cili mund të largojë nga detyra anëtarët e Gjykatës Kushtetuese. Organe të tjera për lëvizjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ligjet tona kushtetuese nuk njohin e as ka.

4. Komisionit të krijuar nga Kuvendi Popullor sipas nenit 4 të ligjit “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve etj.” i janë dhënë kompetenca të mëdha dhe me pasoja të rëndësishme për këtë ose atë person që i shtrohet verifikimit.

Vendimet e këtij komisioni janë të detyruara për të gjitha organet shtetërore. Është pra një organ jo gjyqësor, me kompetenca të jashtëzakonshme dhe me funksione në vazhdimësi, duke filluar nga data 30 nëntor 1995 deri më 31 dhjetor të vitit 2001.

Duke vendosur këto parime lidhur me veprimtarinë dhe vlefshmërinë e vendimeve të

komisionit si dhe të drejtën e të interesuarit për t'u ankuar në Gjykatën e Kasacionit brenda 7 ditëve nga dita e komunikimit të vendimit të Komisionit kapërcehen të gjitha hallkat e tjera gjyqësore siç janë gjykatat e rrethit ashtu dhe ajo e apelit. Kështu, efektivisht, u mohohet personave të interesuar e drejta për një proces të rregullt gjyqësor i parashikuar nga neni 38 i ligjit për "Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut", e drejta për rivendosjen gjyqësore të një të drejte për të cilën flet neni 39 i po atij ligji si dhe garancitë e parashikuara nga neni 40 i po atij ligji. Aq më tepër që një e drejtë e tillë, po sipas kësaj dispozite, përfshihet në kategorinë e atyre të drejtave që nuk mund të kufizohen as edhe në kohën që është shpallur gjendja e luftës apo gjendja e jashtëzakonshme. Po ashtu, në këto raste, për mendimin tim, cenohet edhe një parim tjetër kushtetues dhe konkretisht ai i parashikuar nga neni 25 që bën fjalë për barazinë e personit në ligj dhe para ligjit.

5. Në kushtet e qenies të një vendimi të tillë gjej të justifikuara shfuqizimet, ndryshimet, plotësimet e zëvendësimet si dhe kërkesat e bëra në pjesën urdhëruese të këtij vendimi.

ANËTARI
Veli Budo

MENDIME NË PAKICË PËR PJESË TË VEÇANTA TË VENDIMIT

Duke qenë me shumicën për problemet më thelbësore të vendimit të mësipërm, jemi në pakicë për disa çështje të veçanta të tij e konkretisht :

1. Gjykata Kushtetuese nuk duhej të ishte shprehur për kushtetutshmërinë e nenit 3 të ligjit nr.8001, datë 22.9.1995, mbasi ai është i shfuqizuar nga ligji nr.8043, datë 30.11.1995.

Ligji nr.8043, datë 30.11.1995, jo vetëm përcakton procedurën për kontrollin e figurës së zyrtarëve e personave të tjerë ... organin që bën kontrollin, jo vetëm se zgjeron rrethin e personave që do t'i nënshtrohen kontrollit si dhe organet e funksionet, por zgjidh ndryshe disa probleme nga ligji nr.8001, datë 22.9.1995. Pikërisht këto zgjidhje të ndryshme e bëjnë këtë nen që të jetë shfuqizuar heshtazi. Kështu ndërsa neni 3 i ligjit nr.8001, datë 22.9.1995 me përcaktimin "nuk mund të zgjidhen paskëtaj ... dhe as të emërohen", le të kuptosh se fjala është vetëm për ata që do të zgjidhen e emërohen mbas hyrjes së këtij ligji në fuqi, ligji tjetër, ai me nr.8043, datë 30.11.1995, ndryshon këtë përcaktim: ndërsa për të zgjedhur termin "paskëtaj" e që për këtë nuk ka nevojë për koment, ndërsa për të emëruarit parashikon ndryshe - ata jo vetëm s'mund të emërohen "paskëtaj" por do të largohen nga këto detyra po qe se vërtetohet ndonjë nga shkaqet e nenit 2 të ligjit. Siç shihet kjo s'është "zgjerim" por trajtimi i ndryshëm i problemit nga dispozita e re kundrejt asaj të vjetër. Po kështu, ndërsa neni 3 i ligjit nr.8001, parashikon për të gjitha rastet përjashtimin "kur kanë vepruar kundër vijës zyrtare dhe janë larguar vetë në mënyrë publike", ligji nr.8043, këtë përjashtim e parashikon vetëm për personat e funksionarët e përmendur në gërmat "a" dhe "b" të nenit 2, duke lënë të kuptohet se për të tjerët nuk zbatohet. Siç shihet edhe kjo është një kontradiktë që krahas sa u thanë më lart shërben për të argumentuar se neni 3 i ligjit nr.8001, datë 22.09.1995 është shfuqizuar.

Duke mbrojtur këtë tezë, theksojmë se kjo nuk ndryshon qëndrimin tonë të shprehur në vendim se kufizimi për një kohë të caktuar dhe për subjekte të caktuara i të drejtës së zgjedhjes e emërimit nuk vjen në kundërshtim me dispozitat kushtetuese e aktet ndërkombëtare.

2. Duke qenë se fjala është për të drejta themelore, kemi qenë kundër dhënies së kompetencave organeve ekzekutive në këtë drejtim. Kështu, në shkronjën "ç" të nenit 1 të ligjit nr.8043, datë 30.11.1995, i lihet në fakultet titullarit të ministrisë e institucionit qendror të zgjerojë rrethin e subjekteve që i nënshtrohen kontrollit e largimit nga detyra, kompetencë kjo që duhej të ishte ekskluzivisht e një komisioni të pavarur nga ekzekutivi. Në nenin 3 të ligjit të mësipërm u jepen kompetenca organeve ekzekutive për të bërë përjashtime në strukturat e Forcave të Armatosura. Edhe pse përjashtimet janë të nevojshme, ato përderisa sipas ligjit bëhen "pa prekur interesa të rëndësishme të shtetit" duhej të ishin në kompetencën ekskluzive të Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

ANËTARI
Z.Vuci

ANËTARI
A. Karamuço

Tiranë, më 31 janar 1996